



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:041184
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05842873

PAKR.nr.306/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi - kryetar i kolegjit, Bashkim Hyseni dhe Xhevdet Abazi - anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Syzana Goxhuli, në çështjen penale kundër të akuzuarve O.K dhe A.E, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesat e mbrojtëseve të akuzuarve O.K , av.Arlinda Haziri dhe A.E, av.Sahadete Gashi, të ushtruara kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.84/24 i datës 25.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, me datë 19.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e mbrojtëseve të akuzuarve O.K , av.Arlinda Haziri dhe A.E, av.Sahadete Gashi, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.84/24 i datës 25.04.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë– Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.84/24 i datës 25.04.2024, të akuzuarit O.K dhe A.E për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me

dënim me gjobë në shumë prej tetëqind (800) € secilit veç e veç, i cili dënim do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë. Dënimi me gjobë si më lart, të akuzuarit mund ta paguajnë deri në tre këste.

Janë obliguar të akuzuarit, që secili veç e veç t'i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor duhet të paguaj shumën prej njëqind (100) € dhe nga pesëdhjetë (50) € në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimin, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

Të akuzuarve si më lart, iu konfiskohet dhe shkatërrohet substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë të përgjithshme prej 1.2 gram, e cila është si rezultat i kryerjes së veprës penale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Mbrojtësja e të akuzuarit O.K , av.Arlinda Haziri, për shkak të vendimit mbi sanksion penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoi në ankesë dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar duke e zbutur dënim e shqiptuar.

Mbrojtësja e të akuzuarit A.E, av.Sahadete Gashi, për shkak të vendimit mbi sanksion penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën si të bazuar ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar duke i shqiptuar të akuzuarve një dënim me të butë me gjobë se sa dënimi i shqiptuar.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.289/2024, datë 27.07.2024 ka propozuar që të refuzohen si të pa bazuara ankesat e mbrojtëseve të akuzuarve O.K , av.Arlinda Haziri dhe A.E, av.Sahadete Gashi, ndërsa aktgjykimin i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, në të cilën kanë marrë pjesë mbrojtëset e të akuzuarve O.K , av.Sahadete Gashi dhe A.E, av.Arlinda Haziri, kurse Prokurori i Apelit si dhe të akuzuarit O.K dhe A.E edhe pse kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt nuk morën pjesë në seancë. Mbrojtëset e të akuzuarve qëndruar pranë pretendimeve ankimore të ushtruar me shkrim që të akuzuarve të iu shqiptohet dënim me ulët me gjobë.

Gjykata e Apelit, analizoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësit e të akuzuarit dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore ngase të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, kurse aktgjykimi u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore sa i përket vendimit mbi dënim.

Pretendimet e mbrojtëseve në ankesë

Në ankesë mbrojtësja e të akuzuarit O.K, av.Arlinda Haziri thekson se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, por me rastin e matjes së dënimit edhe pse ka marr parasysh si rrethanat lehtësuese ashtu edhe ato rënduese por me rastin e matjes së dënimit gjykata nuk gjeti veçanërisht rrethana rënduese andaj meqë rrethanat rënduese nuk ekzistojnë në raport me ato lehtësuese si rezultat të mbrojturit tim i ka shqiptuar një dënim shumë të lartë me gjobë i cili nuk konsiston me natyrën, rrezikshmërinë shoqërore dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale. Sipas mbrojtjes dënimi i shqiptuar me gjobë në shumën prej 800€ bie ndesh edhe me vet qëllimin e dënimit i cili duhet të jetë human dhe i arsyeshëm. Ka shtuar se sa i përket rrethanave lehtësuese vetëm janë listuar në arsyetimin e aktgjykimit, megjithatë të njëjtat në dispozitat RPPK-së janë rrethana të cilat e obligojnë gjykatën të merren parasysh në rastin e shqiptimit të dënimit andaj rrethanat e tilla kanë rëndësi në matjen dhe caktimin e dënimit, e jo vetëm të parafrazohen siç ka ndodhë në aktgjykimin e atakuar.

Po ashtu nga gjykata e shkallës së parë nuk është marrë parasysh fakti si sasisë shumë të vogël të narkotikut prej vetëm 1.2 gram dhe atë kjo sasi iu është gjetur të dy bashkëakuzuarave e që i bie se nga 0.6 gram për secilin të akuzuar pasi që së bashku kanë pasur për qëllim që të provojnë për herë të parë substancën narkotike. Bazuar në këtë konsideron se të akuzuarit i është shqiptuar dënim i lartë në krahasim me rastet e ngjashme dhe se nuk është zbatuar unifikimi i praktikës gjyqësore sa i përket caktimit të dënimeve, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Në ankesë mbrojtësja e të akuzuarit A.E, av.Sahadete Gashi thekson se gjykata e shkallës së parë dënimin edhe pse ka marrë parasysh si rrethanat lehtësuese ashtu edhe ato rënduese me rastin e matjes së dënimin i ka mbivlerësuar rrethanat rënduese në raport me ato lehtësuese dhe si rezultat i kësaj të akuzuarit i ka shqiptuar dënim shumë të lartë me gjobë i cili nuk konsiston me natyrën, rrezikshmërinë shoqërore dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale. Sipas mbrojtjes dënimi i shqiptuar me gjobë në shumën prej 800 Euro bie ndesh edhe me vet qëllimin e dënimin i cili duhet të jetë human dhe i arsyeshëm për veprën penale të kryer dhe po ashtu me qëndron fakti se i mbrojturi im është mbajtës i vetëm i familjes tij dhe se shqiptimi i një dënimi të tillë do të rrezikonte seriozisht jetesën e tyre.

Në dispozitat e Kodit, ka përkufizuar se rrethanat lehtësuese obligojnë gjykatën që të shqiptojnë një dënim më të butë kur dihet fakti se i akuzuari qysh fazat e hershme ka shprehur pendim të thellë, ka kërkuar falje për atë çfarë ka ndodhur, në shqyrtim fillestar e ka pranuar fajësinë, gjë që kjo rrethanë, pranimi i fajësisë nga e akuzuari tregon se është penduar, po ashtu nga ana e gjykatës së parë nuk është marrë parasysh fakti si sasisë shumë të vogël të narkotikut prej vetëm 1.2 gram dhe atë kjo sasi i është gjetur të bashkë akuzuarit tjetër e jo të mbrojturit tim.

Tutje ka shtuar se po kjo gjykatë për vepra të njëjta penale ka shqiptuar dënime me te buta, dhe këto aktgjykime janë publike, mbrojtja konsideron se të akuzuarit i është shqiptuar dënim tepër i ashpër në krahasim me të tjerët dhe se për raste të ngjashme, janë përdorur standarde të dyfishta të cilat cenojnë rëndë rendin juridik, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit për një dënim me të butë nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit, kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit ka vlerësuar intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht nuk kemi ndonjë lloj dëmi të shkaktuar, sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar, pranimin e fajit për veprën e kryer penale dhe sipas të dhënave nga evidencat penale të njëjtit më parë nuk kanë qenë të dënuar, duke mos gjetur rrethana veçanërisht rënduese, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se me këtë dënim do të arrihet qëllimi dënimit.

Një vlerësim të këtyre rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara në ankesën e mbrojtëseve se nuk janë vlerësuar rrethanat lehtësuese të cituara dhe janë mbi vlerësuar rrethanat rënduese, janë pretendime të pa bazuara pasi që rrethanat e sipërcituara veç se kanë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë dhe pikërisht si rezultat i këtyre rretheve edhe i është shqiptuar dënim si me lartë, i cili dënim me gjobë është proporcional dhe i justifikueshëm, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit edhe të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe më intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitave të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.306/24, datë 19.06.2024

B. Profesionale,

Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,

Bashkim Hyseni

Kryetar i kolegjit,

Burim Ademi

Xhevdet Abazi
